



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM  
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU  
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



## **RAPORT PERIODIK**

# **MBI VLERËSIMIN E PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË PËRCAKTUARA PËR 6 MUJORIN E PARË TË VITIT 2015 TË PROCESIT RREGULLATOR TË TARIFAVE 2015-2017**

**Periodha raportuese: Janar – Qershor 2015**

**DFTRR/ZRRUK**

Prishtinë, Shtator 2015

## **Vizioni**

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efëiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

## **Misioni**

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

## PËRMBAJTA

1.	Hyrje .....	5
2.	Sfidimi i biznes planeve rregullatore .....	6
3.	Aplikimi i inflacionit .....	7
4.	Metodologjia e vlerësimit të caqeve .....	8
5.	Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët .....	9
5.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m <sup>3</sup> dhe numrit të konsumatorëve.....	10
6.	Analiza e shpenzimeve operative.....	12
6.1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza.....	13
6.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza .....	14
6.2	Shpenzimet e pagave.....	15
6.3	Mbulimi i shpenzimeve të operative dhe të investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit .....	16
7.	Shuma e faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare .....	17
7.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	18
7.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza.....	19
7.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza .....	19
7.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza .....	21
8.	Investimet kapitale .....	22
8.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	23
8.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive .....	26
8.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët .....	27
8.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët .....	30
9.	Rangimi i KRU-ve sipas realizimit të caqeve .....	31
10.	Konkluzionet e raportit.....	36

## Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
FE	Kompania Rajonale e Ujit “Bifurkacioni” sh. a –Ferizaj
GJA	Kompania Rajonale e Ujit “Radoniqi” sh. a – Gjakovë
GJI	Kompania Rajonale e Ujit “Hidromorava” sh. a – Gjilan
MIT	Kompania Rajonale e Ujit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë
PE	Kompania Rajonale e Ujit “Hidrodrini” sh. a – Pejë
PR	Kompania Rajonale e Ujit “Prishtina” sh. a – Prishtinë
PZ	Kompania Rajonale e Ujit “Hidroregjioni-Jugor” sh. a – Prizren
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
BARRA	Baza Rregullatore e Aseteve

# 1 HYRJE

---

Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin e parë periodik të punës për 6 mujorin e parë të vitit 2015 me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve, të procesit rregullatorë të tarifave afatmesme 2015-2017. Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë të tarifave gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifor 2015-2017, për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2015, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2015 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur në gjashtë mujorin e parë të vitit 2014.

Qëllimi i këtij raporti është:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për periudhën e shikuar kohore.
- (ii) Të krahasohen treguesit e KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndër marrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendët e tilla gjatë pjesës së mbetur të procesit tarifor të vitit 2015 nga procesi rregullatorë 2015-2017.

Duke pasur parasysh që KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

## 2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

---

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2015-2017 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar BPRR-t e kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve.

Parimi bazë i procesit rregullator të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 është krijimi i parakushteve për një qëndrueshmëri financiare për kompanitë, që nënkupton; kosto optimale operative për sasi dhe cilësi të caktuar shërbimi për konsumatorët e shërbyer, të cilat kemi shpresuar dhe shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të performancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ZRRUK, mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne, besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2015-2017.

Prandaj, ZRRUK do të kryej monitorimin e rregullt të gjithë periudhës tarifore 2015-2017 për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator, siç po bëjmë edhe me këtë raport.

### 3 APLIKIMI I INFLACIONIT

---

Përderisa qëllimi i këtij raporti kryesisht ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2015-2017, për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2015, dhe për të qenë vlerësimi sa më real, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK të paraqitura në tabelat e mëposhtme janë të përshtatura me Indeks të Konsumit në Kosovë publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës të periudhës vlerësuese.

Duhet theksuar se, të dhënat financiare të aprovuara për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 kanë marrë për bazë çmimet e mesit të vitit 2014 (Qershor 2014 = kur IÇKK-ja ishte 127.3), ngase BPRR për procesin tarifar 2015-2017 janë dorëzuar gjatë asaj kohe, të cilat gjatë procesit të përcaktimit të tarifave të vitit 2015 janë indeksuar me Indeks të Konsumit të Çmimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të sqaruar në pargarfain e 4 të kësaj pjese.

Për këtë, të dhënat financiare të aprovuara nga ZRRUK ndryshojnë prej të dhënave financiare që gjenden në BPRR e KRU-ve, por të njëjtat janë të njoftuara në detaje me shumat e tilla financiare pas indeksimit, pasi që të gjitha kompanitë individualisht i kanë marrë raportet përmblyëse tarifore të vitit 2015-2017.

Të dhënat financiare të aprovuara, në këtë raport, kanë marrë për bazë të dhënat e BPRR-ve duke i shumëzuar me IÇKK 0.99869. Ky indeks është fituar duke pjesëtuar mesataren e IÇKK për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 (127.133) me IÇKK mesit të vitit 2014 (127.3).

Sikurse edhe u theksua më lartë qëllimi i këtij raporti ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifar 2015-2017 gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015.

## 4 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2015, do të jetë uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2014,
- të dhënat e aprovuara nga ZRRUK për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015,
- të dhënat e realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015,
- përqindja krahasuese e gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 me gjashtë mujorin e parë të 2014,
- përqindja krahasuese e realizimit të caktuar të gjashtë mujorit të parë të vitit 2015, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese e gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2015 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2014 është raporti i të dhënave të dalës nga treguesit e arritur të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100. Përqindja krahasuese e realizimit të caktuar për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2015 del si rezultat i raportit të dhënave të aprovuara dhe të përcaktuara si cak me të dhënat e realizuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin në përgjithësi të shumëzuar me 100. Vlerësimi përfundimtar për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2015 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësimi rregullatorit, dhe identifikohet si:

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat e shpenzimeve operative dhe ujit të humbur në m<sup>3</sup>.

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
< 98.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.00% - 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
102.01%- 106.00%	P	E përfruar	Negativ
> 106.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat tjera

Kufijtë	Shkurtesa	Përshkrimi	Vlerësimi
> 102.00 %	T P	Tejkaluar pozitivisht plus	Pozitiv +
98.01% – 102.00%	R	E realizuar	Pozitiv
94.00% – 98.00%	P	E përfruar	Negativ
<94.00%	Jo e R	Jo e Realizuar	Negativ -
	E pa K	E pa krahasueshme	Pa të dhëna krahasuese

## 5. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT




Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m<sup>3</sup>): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.



Tabela Nr. 1. Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë 6m 2015 krahasuar me të dhënat e 6m 2014 dhe caqet e përcaktuara për 6m 2015.

Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia matëse	Historike 6m 2014	Aprovuara 6m 2015	Realizuara nga KRU-të 6m 2015	% krahasuese 2015/2014	% real cak 6m2015	Vlerësimi për 6m 2015
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	17,481,055	22,083,332	20,446,562	116.96%	92.59%	Jo e R
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	8,206,113	9,890,326	10,405,997	126.81%	105.21%	P
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	9,274,942	12,193,006	10,040,565	108.25%	82.35%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	116,247	106,207	110,216	94.81%	103.77%	TP
Hidroregjio ni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	8,486,139	10,308,434	8,227,791	96.96%	79.82%	Jo e R
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	5,090,942	5,837,893	4,749,765	93.30%	81.36%	TP
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	3,395,197	4,470,541	3,478,026	102.44%	77.80%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	39,619	43,059	41,609	105.03%	96.63%	P
Hidrodriini (PE)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	15,356,065	12,773,625	12,808,597	83.41%	100.27%	R
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	11,126,527	7,928,625	8,692,689	78.13%	109.64%	Jo e R
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	4,229,538	4,845,000	4,115,908	97.31%	84.95%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	39,801	39,491	41,494	104.26%	105.07%	TP
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	8,495,674	8,967,098	11,259,353	132.53%	125.56%	TP
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	4,755,646	3,526,497	6,438,329	135.38%	182.57%	Jo e R
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	3,740,028	5,440,601	4,821,024	128.90%	88.61%	Jo e R
	Faturimi-Jug	m <sup>3</sup>	2,103,012	3,090,601	2,300,819	109.41%	74.45%	Jo e R
	Faturimi-Veri	m <sup>3</sup>	1,637,016	2,350,000	2,520,205	153.95%	107.24%	TP
	Konsumatorët	Nr	27,522	25,024	25,011	90.88%	99.95%	R
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	6,830,945	7,063,694	6,900,878	101.02%	97.70%	P
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	3,465,616	3,338,509	3,521,429	101.61%	105.48%	P
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	3,365,329	3,725,185	3,379,449	100.42%	90.72%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	30,180	30,213	31,501	104.38%	104.26%	TP
Bifurkacion i (FE)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	3,255,369	3,760,986	3,771,875	115.87%	100.29%	R
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	1,884,619	1,739,859	2,005,320	106.40%	115.26%	Jo e R
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	1,370,750	2,021,128	1,766,555	128.88%	87.40%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	18,091	22,648	22,936	126.78%	101.27%	R
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	3,587,400	3,866,595	3,964,822	110.52%	102.54%	TP
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	2,119,081	1,898,500	2,348,832	110.84%	123.72%	Jo e R
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	1,468,319	1,968,095	1,615,990	110.06%	82.11%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	23,753	23,621	22,605	95.17%	95.70%	P
SEKTORI	Uji i prodhuar	m <sup>3</sup>	63,492,647	68,823,763	67,379,878	106.12%	97.90%	P
	Uji i humbur	m <sup>3</sup>	36,648,544	34,160,208	38,162,361	104.13%	111.72%	Jo e R
	Uji i faturuar	m <sup>3</sup>	26,844,103	34,663,555	29,217,517	108.84%	84.29%	Jo e R
	Konsumatorët	Nr	295,211	290,262	293,601	99.45%	101.15%	R

## 5.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në m<sup>3</sup> dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2014 me të dhënat e aprovuara nga ZRRUK dhe të dhënave të realizuara nga KRU-të në gjashtë mujorin e parë të vitit 2015.





Gjendja e sektorit të ujit në Kosovë mund të paraqitet duke shfrytëzuar **Diagramin Merimangë**. Përpos tek të dhënat operative, ky diagram do të shfrytëzohet edhe tek kategoritë tjera të të dhënave në këtë raport.

**Septagrami (Iakorja)** me ngjyrë të kuqe (shtatë këndesh) paraqet sasinë e ujit të prodhuar nga të gjitha KRU-të në Kosovë shprehur në përqindje. Hapësira e kaltër tregon sa përqind e ujit të prodhuar faturohet. Ndërkaq, hapësira me ngjyrë të gjelbër paraqet në përqindje se sa prej ujit të prodhuar arkëtohet.

Hapësira me ngjyrë të hirtë e paraqet ujin e humbur për çdo kompani veç e veç dhe për sektor, kurse hapësira me ngjyrë të kaltër paraqet llogaritë e arkëtueshme–borxhet e konsumatorëve ndaj kompanive për periudhën e shikuar të vitit 2015. Ndërkaq, vetëm hapësira me ngjyrë të gjelbër e tregon në mënyrë figurative se sa përqind e ujit të prodhuar kthehet në para.

Për të qenë KRU-të në gjendje të mirë financiare dhe me nivele të kënaqshme të shërbimit për konsumatorët e tyre, kompanitë duhet të ngrisin performancën e tyre në krahasim me atë që është.

## 6. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

---

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2015-2017, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK ([www.wwro-ks.org](http://www.wwro-ks.org)).


## 6.1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2014, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.



Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €


Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Valuta	Historike 6m 2014	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2015	Realizuara nga KRU 6m 2015	% Krahasues e 6m 2015/2014	% e real. të cakt. 6m2015	Vlerësimi përfundimtar për 6m 2015
Prishtina (PR)	Ujë	€	3,887,016	4,090,473	3,938,150	101.32%	96.28%	TP
	Ujëra të Zeza	€	113,706	260,838	120,360	105.85%	46.14%	TP
	<b>Totali</b>	€	<b>4,000,722</b>	<b>4,351,311</b>	<b>4,058,510</b>	<b>101.44%</b>	<b>93.27%</b>	TP
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,342,874	1,517,170	1,394,779	103.87%	91.93%	TP
	Ujëra të Zeza	€	168,999	102,630	193,014	114.21%	188.07%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>1,511,873</b>	<b>1,619,800</b>	<b>1,587,793</b>	<b>105.02%</b>	<b>98.02%</b>	R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	894,810	973,694	1,002,194	112.00%	102.93%	P
	Ujëra të Zeza	€	80,696	61,163	26,555	32.91%	43.42%	TP
	<b>Totali</b>	€	<b>975,506</b>	<b>1,034,857</b>	<b>1,028,749</b>	<b>105.46%</b>	<b>99.41%</b>	R
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	880,858	793,096	1,002,081	113.76%	126.35%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	120,715	97,868	161,947	134.16%	165.48%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>1,001,573</b>	<b>890,964</b>	<b>1,164,028</b>	<b>116.22%</b>	<b>130.65%</b>	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,115,477	1,047,475	1,261,513	113.09%	120.43%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	48,779	126,440	46,889	96.13%	37.08%	TP
	<b>Totali</b>	€	<b>1,164,255</b>	<b>1,173,915</b>	<b>1,308,402</b>	<b>112.38%</b>	<b>111.46%</b>	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	386,717	548,821	506,724	131.03%	92.33%	TP
	Ujëra të Zeza	€	92,326	78,249	118,464	128.31%	151.39%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>479,043</b>	<b>627,070</b>	<b>625,188</b>	<b>130.51%</b>	<b>99.70%</b>	R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	553,722	564,993	653,193	117.96%	115.61%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	61,058	52,752	65,191	106.77%	123.58%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>614,780</b>	<b>617,745</b>	<b>718,384</b>	<b>116.85%</b>	<b>116.29%</b>	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	<b>9,061,472</b>	<b>9,535,722</b>	<b>9,758,634</b>	<b>107.69%</b>	<b>102.34%</b>	P
	Ujëra të Zeza	€	<b>686,280</b>	<b>779,940</b>	<b>732,420</b>	<b>106.72%</b>	<b>93.91%</b>	TP
<b>Totali i përgjithshëm sektorial</b>		€	<b>9,747,752</b>	<b>10,315,661</b>	<b>10,491,054</b>	<b>107.63%</b>	<b>101.70%</b>	R

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur gjatë 6m të vitit 2015, 93.02% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 6.98% janë shpenzime të ujërave të zeza. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të gjatë vitit 2015 është 10,491,054€, të cilat si të tilla janë tejkaluar nga shuma e aprovuar nga ZRRUK për këtë periudhë në lartësi prej 1.70%.



## 6.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza





Prej këtij grafikoni shihet se nga shuma e shpenzimeve të aprovuar për periudhën e shikuar të vitit 2015, KRU “Prishtina”, “Hidroregjioni Jugor”, “Hidrodrini” dhe “Bifurkacioni” kanë arritur t’i kenë brenda limiteve të përcaktuara nga Rregullatori shpenzimet e veta.

## 6.2 Shpenzimet e pagave

Është e ditur se kostoja e pagave për të punësuarit në të gjitha KRU-të paraqesin zërat më të larta të tyre dhe për t’i pasqyruar të njëjtat në raport me kostot tjera po i paraqesim në Tabelën e më poshtme, prej nga mund të kuptojmë lehtë se cila kompani menaxhon më mirë me zërin e pagave. Pasi dihet që ky zë i kostove është më ndikuesi, sikurse po paraqesim edhe pagat mesatare për secilën kompani dhe për sektorin.

*Tabela Nr. 3 Shpenzimet e pagave në raport me shpenzimet totale dhe paga mesatare për vitin 2015*

Emri i Kompanisë	Totali i shpenzimeve operative të realizuara	Totali i shpenzimeve të pagave të realizuara	Numri i të punësuarve	Përqindja e pagave në raport me shpenzimet e realizuara	Paga mesatare mujore
	€	€	Nr	%	€/muaj
PRISHTINA	4,058,510	2,384,081	549	58.74%	742.42
HIDROREGJIONI-JUGOR	1,587,793	889,747	313	56.04%	473.77
HIDRODRINI	1,028,749	661,010	213	64.25%	518.44
MITROVICA	1,164,028	664,135	227	57.05%	487.62
RADONIQI	1,308,402	963,364	260	73.63%	617.54
BIFURKACIONI	625,188	491,268	177	78.58%	462.15
HIDROMORAVA	718,384	495,958	152	69.04%	542.62
<b>SEKTORI</b>	<b>10,491,054</b>	<b>6,549,563</b>	<b>1,891</b>	<b>62.43%</b>	<b>577.41</b>

### 6.3 Mbulimi i shpenzimeve operative dhe të investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat e shumës së shpenzimeve të ndodhura për çdo kompani veç e veç dhe shumës së arkëtimit, për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, në të cilën paraqitet shkalla e mbulueshmërisë së shpenzimeve operative pa amortizim me arkëtim, dhe shkallës së mbulueshmërisë së shpenzimeve operative pa amortizim dhe me investime kapitale, me arkëtim. E njëjta tregon të dhënën e efijencës së çdo kompanie dhe sektorit përgjatë periudhës së shikuar.

Tabela Nr.4 Pasqyra e të dhënave të mbulueshmërisë së të hyrave të arkëtuara me shpenzimet e përgjithshme operative pa amortizim dhe të investimeve kapitale vetanake, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2015.

Nr	Emri i kompanisë	Arkëtimi €	Shpenzimet operative pa amortizim €	Mbetja financiare €	Investimet kapitale vetanake €	Shkalla e mbulueshmërisë se shpenzimeve operative pa amortizim me arkëtim €	Shkalla e mbulueshmërisë se shpenzimeve operative dhe investimeve me arkëtim €
		A	B	C=(A-B)	D	E=A/B	F=A/(B+D)
1	Prishtina	4,424,192	4,058,510	365,682	299,108	1.09	1.02
2	Hidroregjioni Jugor	1,363,012	1,587,793	-224,781	9,071	0.86	0.85
3	Hidrodrini	1,036,258	1,028,749	7,510	0	1.01	1.01
4	Mitrovica	640,792	1,164,028	-523,235	0	0.55	0.55
5	Radoniqi	1,325,792	1,308,402	17,390	270,354	1.01	0.84
6	Bifurkacioni	589,301	625,188	-35,887	25,170	0.94	0.91
7	Hidromorava	610,281	718,384	-108,103	2,556	0.85	0.85
	Sektori	9,989,628	10,491,054	-501,425	606,258	0.95	0.90

## 7. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

---

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga kompanitë dhe sektori, në të cilat hynë të dhënat historike të realizuar gjatë gjashtë mujorit të vitit 2014, pastaj të dhënat e aprovuara nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2015-2017.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015 me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2014.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2014, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të zeza, ZRRUK ka qenë i detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ZRRUK dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

### *Shënim:*

*Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit, që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ZRRUK-ut të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.*


## 7.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të gjashtë mujorit të parë të vitit 2014, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2015.

Tabela Nr. 5 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Valuta	Historike 6m2014	Aprovuara nga ZRRUK 6m2015	Realizuar nga KRU 6m2015	% Krahasu. 2015/2014	% e real. të caktut 6m2015	Vlerësi mi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,391,609	6,708,387	5,718,228	106.06%	85.24%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	520,512	654,915	562,205	108.01%	85.84%	Jo e R
	Totali	€	<b>5,912,121</b>	<b>7,363,301</b>	6,280,433	106.23%	85.29%	Jo e R
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,710,345	2,185,818	1,758,982	102.84%	80.47%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	170,309	256,676	211,037	123.91%	82.22%	Jo e R
	Totali	€	<b>1,880,654</b>	<b>2,442,494</b>	1,970,019	104.75%	80.66%	Jo e R
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,493,864	1,663,848	1,501,142	100.49%	90.22%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	159,202	166,927	150,287	94.40%	90.03%	Jo e R
	Totali	€	<b>1,653,066</b>	<b>1,830,775</b>	1,651,428	99.90%	90.20%	Jo e R
Mitrovica (MIT)	Ujë-Jugu	€	990,099	1,395,797	1,091,175	110.21%	78.18%	Jo e R
	Ujë-Veriu	€	278,293	399,572	428,557	153.99%	107.25%	P
	Ujëra të Zeza	€	198,820	251,367	220,719	111.01%	87.81%	Jo e R
	Totali <sup>1</sup>	€	<b>1,188,919</b>	<b>1,647,164</b>	1,311,894	110.34%	79.65%	Jo e R
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,534,088	1,718,200	1,562,806	101.87%	90.96%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	196,475	227,457	240,142	122.23%	105.58%	P
	Totali	€	<b>1,730,563</b>	<b>1,945,657</b>	1,802,948	104.18%	92.67%	Jo e R
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	682,308	911,151	887,043	130.01%	97.35%	P
	Ujëra të Zeza	€	137,938	278,535	218,485	158.39%	78.44%	Jo e R
	Totali	€	<b>820,246</b>	<b>1,189,686</b>	1,105,528	134.78%	92.93%	Jo e R
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	694,896	893,590	753,965	108.50%	84.37%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	125,598	136,443	132,748	105.69%	97.29%	P
	Totali	€	<b>820,494</b>	<b>1,030,033</b>	886,713	108.07%	86.09%	Jo e R
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	12,775,502	15,876,363	13,701,898	107.25%	86.30%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	1,508,854	1,972,320	1,735,622	115.03%	88.00%	Jo e R
Totali i përgjithshëm sektorial		€	<b>14,284,357</b>	<b>17,848,683</b>	<b>15,437,520</b>	<b>108.07%</b>	<b>86.49%</b>	<b>Jo e R</b>

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë, 88.76 % të shumës së faturimit realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 11.24% rrjedh nga shërbimi i ujërave të zeza. Në total për sektorin, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2015 është realizuar faturimi në vlerë prej 15,437,520€, e që paraqet 86.49% të shumës së aprovuar nga procesi rregullatorë për 6 mujorin e vitit 2015.



<sup>1</sup> Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturara për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

## 7.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza



Nga grafikoni vërehet se asnjëra KRU nuk ka arritur të realizoj faturimin në Euro ashtu siç është aprovuar nga ZRRUK në procesin tarifar 2015-2017, për 6 mujorin parë të vitit 2017. Si rezultat i kësaj kemi edhe të dhënat sektoriale për këta tregues të cilat i konsiderojmë jo të mira.

## 7.3. Shuma e arkëtimit për


## shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të 6 mujorit të parë të vitit 2014, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2015.

Tabela Nr. 6 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare




Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 6m 2014	Aprovuara nga ZRRUK 6m 2015	Realizuara nga KRU 6m 2015	% krahasuese 6m 2015/ 2014	% e real. të caktut 6m 2015	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	4,041,323	5,225,476	4,003,424	99.06%	76.61%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	420,107	516,212	420,768	100.16%	81.51%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>4,461,431</b>	<b>5,741,688</b>	<b>4,424,192</b>	<b>99.17%</b>	<b>77.05%</b>	<b>Jo e R</b>
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,262,111	1,709,145	1,217,049	96.43%	71.21%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	125,417	203,063	145,963	116.38%	71.88%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>1,387,528</b>	<b>1,912,208</b>	<b>1,363,012</b>	<b>98.23%</b>	<b>71.28%</b>	<b>Jo e R</b>
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	808,482	1,211,557	941,943	116.51%	77.75%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	86,148	126,430	94,315	109.48%	74.60%	Jo e R
	<b>Totali</b>	€	<b>894,630</b>	<b>1,337,988</b>	<b>1,036,258</b>	<b>115.83%</b>	<b>77.45%</b>	<b>Jo e R</b>
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	447,738	814,087	546,364	122.03%	67.11%	Jo e R
	Subvencionet	€	183,427	260,000	173,698	94.70%	66.81%	Jo e R
	Ujërat e zeza	€	81,223	154,152	94,429	116.26%	61.26%	Jo e R
	<b>Totali<sup>2</sup></b>	€	<b>528,960</b>	<b>968,239</b>	<b>640,792</b>	<b>121.14%</b>	<b>66.18%</b>	<b>Jo e R</b>
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,104,966	1,311,073	1,149,509	104.03%	87.68%	Jo e R
	Ujëra të Zeza	€	141,465	176,241	176,283	124.61%	100.02%	R
	<b>Totali</b>	€	<b>1,246,431</b>	<b>1,487,313</b>	<b>1,325,792</b>	<b>106.37%</b>	<b>89.14%</b>	<b>Jo e R</b>
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	382,445	634,636	472,496	123.55%	74.45%	Jo e R
